



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme /Departman za Finansije i Opšte Usluge /Department of Finance and General Services

Ministria e Zhvillimit Ekonomik shpallë **KONKURS PËR AVANCIM** të nëpunësve civilë për këtë vend të punës:

Divizioni për Komunikim Publik

Vendi i punës: Udhëheqës për Komunikim me Publikun - IN/010

Numri i Konkursit: APF0005109

Koeficienti : 9.00

Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar

Mbikëqyrësi: Sekretari i Përgjithshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheq Divizionin e Komunikimit Publik dhe cakton objektivat si dhe zhvillon planin e punës për përmbushjen e këtyre objektivave. 15%
- Menaxhon stafin e divizionit dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve cilësore. 15%
- Siguron hartimin dhe zbatimin e planit të komunikimit për të informuar qytetarët, institucionet dhe komunitetin e biznesit për politikën, arritjet dhe aktivitetet e ministrisë dhe siguron redaktimin dhe përditësimin e tyre. 15%
- Harton kalendarin e mbulimit medial të aktiviteteve të ministrit dhe të ministrisë, dhe i harmonizon me kalendarin e mbulimit medial në nivel qeveritar si dhe komunikon me media. 15%
- Siguron aplikimin e standardeve të komunikimit publik, nëpërmjet trajnimit dhe avancimit, me qëllim që funksionet e zyrës të ushtrohen në mënyrën më efektive dhe efikase. 15%

- Zëvendëson zëdhënësin e ministrisë në mungesë të tij dhe bashkëpunon me zyrën për informim të ZKM-së për të siguruar që politikat dhe arritjet e ministrisë të prezantohen në kuadër të njoftimeve të Qeverisë. 10%
- Siguron hartimin dhe zhvillimin e politikave të fjalimeve dhe opinioneve për të gjitha temat e rëndësishme lidhur me aktivitetet dhe shërbimet e ministrisë. 10%
- Bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara. 10%

Kualifikimi i nevojshëm :

- Diploma universitare, fakulteti i gazetarisë ose në ndonjë fushë të përafërt, 5 vite përvojë pune profesionale)
- Njohuri dhe përvojë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit publik, shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim
- Fleksibilitet ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internet)

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT PER AVANCIM

Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunës civil ekzistues në MZHE, te cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim. MZHE ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda MZHE-së. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (Sheshi Nëna Terezë, Toskanë, Prishtinë) Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen <http://mzhe.rks-gov.net>

Së bashku me formularin zyrtar të punësimit duhet të dorëzohet dëshmia për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, dëshmitë për përvojën e punës, dy vlerësimet e fundit të punës si dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Kërkesat dorëzohen në Zyrën e Arkivës, kati I-rë, ndërtesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ose me postë.

Afati i konkurrimit është prej datës 16/04/2019 deri me datë 23/04/2019, deri në orën 16:00.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 21524.